ZEUS-AL

Bojra & Vernige

WASH PRIMER

ASTAR SPECIAL PËR SIPËRFAQE
TË XINGUARA & ALUMINI



PËRSHKRIMI TEKNIK

WASH PRIMER është një produkt i veçantë me cilësi të shkëlqyera anti korrozive dhe aftësi ngjitëse shumë të mirë mbi sipërfaqet prej hekuri dhe alumini. Ky produkt është dizenjuar në mënyrë të veçantë për mbrojtjen e lartë të të gjitha sipërfaqeve metalike.
Për shkak të formulës së tij të veçantë ai përdoret në sipërfaqet e vështira ku astarët e mëparshëm kanë dështuar. Ai ka aftësinë të krijojë një shtresë të ndërmjetme midis sipërfaqes metalike dhe shtresës perfundimtare te bojës duke mos lejuar depërtimin e korrozionit në sipërfaqen metalike.

CILËSITË

WASH PRIMER ka aftësi ngjitjeje mbi sipërfaqet e vështira sikurse metalet e xinguara, alumini, xhami, inoksi etj. Thahet shpejt dhe kombinon shkëlqyer elasticitetin me fortësinë dhe paraqet një rezistencë jashtëzakonisht të lartë për tu mbuluar nga bojrat me një komponent. Për më tepër, është rezistent ndaj ujit, vajit, solventëve organik dhe naftës.
Produkti mund të aplikohet me furcë , rul ose pistoletë.

FUSHA E APLIKIMIT

Sugjerohet të përdoret në kushte jashtëzakonisht të vështira sikurse janë ambientet industriale dhe detare. Mund të aplikohet te anijet dhe varkat në pjesën sipër ujit, mbi dyert metalike, parmakët e shkallëve, makineritë etj.

VOC (Përbërësit e Paqëndrueshëm Organik)
Vlera limit e BE: për këtë kategori produkti A/i (Bojra specifike me një komponent): 500g/l (2010).
Ky produkt përmban maksimalisht 499 g/l VOC.

ZEUS - AL Adresa: L.14, Rr. "Asti Gogoli", ish NPA, Shkozet - Durrës
Tel: +355 52 265 461 / E-mail: info@zeus-al.com
web: www.zeus-al.com

WASH PRIMER

ASTAR SPECIAL PËR SIPËRFAQE TË XINGUARA & ALUMINI



APLIKIMI

Sipërfaqja që dëshirojmë të lyejmë duhet të jetë e pastër,e thatë, pa praninë e shtresave të vjetra të bojës, vajrave, yndyrnave, kripërave, ndryshkut ,etj.
Hollimi për furçë ose rul: 5-10% sipas peshës,me BRUSH SOLVENT No 100 të **ZEUS-AL**.
Hollimi për furçë ose rul: 5-10% sipas peshës, me SPRAY SOLVENT No 200 të **ZEUS-AL**.
Aplikimi: Aplikoni 1-2 duar mbi sipërfaqen e pastruar dhe të përgatitur mirë.
Temperatura e përdorimit: 5 deri në 35°C.
Rilyerja: Mund të rilyhet nga bojrat me një komponent të **ZEUS-AL**.

TË DHËNA TEKNIKE

Ngjyra: Gri
Shkëlqimi në 60°: 15 ± 5 (ELOT EN ISO 2813-99)
Densiteti: 1.25 ± 0,02 gr/ml (ISO 2811)
Viscosity, DIN 6, ne 25°C: 60-80 sec (ISO 2884.02-03)
Viskoziteti në aplikim me pistoletë 4 mm: 18-22 sec (ISO 2884.02-03)
Substanca të ngurta sipas peshës , %: 76 ±2 (ELOT EN ISO 3251-03)
Koha e tharjes në 25°C:

- Tharja në sipërfaqe: 10-20 min
- Tharje me prekje: 30-45 min
- Tharje e plotë 16 orë
- Rilyerja: pas 6-10 orë

Pika e ndezjes: 26°C (ELOT EN ISO 1523-02)
Fortësia (Könnig): 55 ±5 pas 7 ditësh (ELOT EN ISO 1522-00)
Ngjitja ne metal ose dru (ndër-prerë): 0 (ELOT EN ISO 2409-95)
Elasticiteti (testi i Mandrelit): 3±1 mm pass (ELOT EN ISO 1519-02)
Mbulimi: 9 -10 m²/lit për shtresë në sipërfaqet e përgatitura mirë.

PËR APLIKIM ME PISTOLETË:
Përdoreni gjithmone në ambiente të ajrosura mirë duke përdorur maskë dhe doreza të përshtatshme për mbrojtje.
Mos i thithni avujt.

ZEUS - AL Adresa: L.14, Rr. "Asti Gogoli", ish NPA, Shkozet - Durrës
Tel: +355 52 265 461 / E-mail: info@zeus-al.com
web: www.zeus-al.com